



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 8 janar 2019
Nr. ref.:RK 1315/19

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI151/17

Parashtrues

Elife Murseli

**Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës
Supreme, Pml. nr. 195/2017, të 11 tetorit 2017**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga znj. Elife Murseli, nga fshati Doganaj, komuna e Kaçanikut (në tekstin e mëtejme: parashtruesja e kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesja e kërkesës konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, Pml. nr. 195/2017, të 11 tetorit 2017.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimit të kontestuar, për të cilin parashtruesja pretendon se i ka shkelur nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe nenin 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] të Kushtetutës.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 31 të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).
5. Më 31 maj 2018, Gjykata Kushtetuese (në tekstin e mëtejme: Gjykata) miratoi, në seancë administrative, plotësim-ndryshimin e Rregullores së punës, e cila u publikua në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës më 21 qershor 2018 dhe hyri në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas publikimit të saj. Rrjedhimisht, gjatë shqyrtimit të kërkesës, Gjykata i referohet dispozitave juridike të rregullores së re në fuqi.

Procedura në Gjykatë

6. Më 12 dhjetor 2017, parashtruesja e dorëzoi kërkesën në Gjykatë.
7. Më 15 dhjetor 2017, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Ivan Čukalović gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetarja e Gjykatës caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Snezhana Botusharova (kryesuese), Bekim Sejdiu dhe Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, anëtarë.
8. Më 16 janar 2018, Gjykata e njoftoi parashtruesen për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme.
9. Më 16 qershor 2018, u përfundoi mandati gjyqtarëve: Snezhana Botusharova dhe Almiro Rodrigues. Më 26 qershor 2018, u përfundoi mandati gjyqtarëve: Altay Suroy dhe Ivan Čukalović.
10. Më 9 gusht 2018, Presidenti i Republikës së Kosovës emëroi gjyqtarët e rinj: Bajram Ljatifi, Safet Hoxha, Radomir Laban, Remzije Istrefi-Peci dhe Nexhmi Rexhepi.
11. Më 17 gusht 2018, Kryetarja e Gjykatës nxori vendimin për zëvendësimin e gjyqtarit raportues Ivan Čukalović, dhe në vend të tij u caktua gjyqtari Bajram Ljatifi, ndërsa më 23 tetor Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Remzije Istrefi-

Peci, anëtare të Kolegjit shqyrtues, në vend të ish-gjyqtarës Snezhana Botusharova.

12. Më 11 dhjetor 2018, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës

Përmbledhja e fakteve

13. Më 28 prill 2014, rreth orës 14:32 në magjistralen Prishtinë-Ferizaj, në fshatin Banullë, komuna e Lipjanit, ka ndodhur një aksident komunikacioni në të cilin ishte e përfshirë edhe parashtruesja e kërkesës.
14. Më 1 shtator 2014, Prokuroria Themelore në Prishtinë ka ngritur aktakuzën me nr. PP. nr. 3535/2014, duke e akuzuar parashtruesen për kryerje të veprës penale, "Rrezikimi i trafikut publik" nga neni 378, paragrafi 6, lidhur me par. 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (Në tekstin e mëtejme: KPRK).
15. Më 12 shtator 2014, Gjykata Themelore në Prishtinë-Dega në Lipjan, me Aktgjykimin P. nr. 231/14 i cili përmban edhe urdhrin ndëshkimor, parashtruesen e ka shpallur fajtores për veprën penale, "Rrezikimi i trafikut publik" nga neni 378, paragrafi 6, lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së dhe e ka dënuar me gjobën në shumë të pacaktuar si në dispozitivin e urdhrit ndëshkimor.
16. Më 23 shtator 2014, parashtruesja nëpërmjet shërbimit postar ka ushtruar kundërshtim ndaj aktgjykimit të lartcekur dhe urdhrit ndëshkimor si pjesë përbërëse e tij.
17. Më 10 tetor 2014, Gjykata Themelore në Prishtinë-Dega në Lipjan, me Aktvendimin me të njëjtin numër, P. nr. 231/14, e ka hedhur poshtë si të paafatshëm kundërshtimin e parashtrueses.
18. Më 17 tetor 2014, parashtruesja ka ushtruar ankesë kundër aktvendimit me të cilën u refuzua kundërshtimi i saj në Kolegjin e Gjykatës Themelore në Prishtinë.
19. Më 3 prill 2015, Kolegji i përbërë prej 3 (tre) gjyqtarëve aprovoi si të bazuar ankesën e parashtrueses dhe deklaroi kundërshtimin e saj si të afatshëm dhe vendosi që *"çështja të kthehet në fazën e shqyrtimit kryesor"*.
20. Më 23 maj 2016, pasi që tashmë me aktvendim çështja ishte kthyer në fazën e shqyrtimit kryesor, Gjykata Themelore në Prishtinë-Dega në Lipjan, me Aktgjykimin P. nr. 231/14, parashtruesen e shpalli fajtores për veprën penale "Rrezikimi i trafikut publik", sipas nenit 378, paragrafi 6, lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së dhe e gjykoi me gjobë në shumën të përcaktuar si në dispozitivin e aktgjykimit.
21. Më 13 qershor 2016, parashtruesja nëpërmjet mbrojtësit të saj ligjor paraqiti ankesë kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore, me të cilën ishte shpallur fajtores për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe vërtetimit të gabueshëm dhe jo të plotë të gjendjes faktike.

22. Më 11 tetor 2016, Gjykata e Apelit me Aktgjykimin PAI. nr. 859/2016, refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtrueses dhe vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Lipjan.
23. Më 10 korrik 2017, parashtruesja paraqiti kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme të Kosovës.
24. Më 11 tetor 2017, Gjykata Supreme e Kosovës, me Aktgjykimin Pml. nr. 195/2017, refuzoi si të pabazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

25. Parashtruesja e kërkesës ka pretenduar se me vendimet e kontestuara, asaj i janë shkelur nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] të Kushtetutës.
26. Më tej, parashtruesja ka kërkuar nga Gjykata që t'i shfuqizojë të gjitha vendimet gjyqësore të të gjitha instancave dhe të deklarojë kërkesën të pranueshme.

Pranueshmëria e kërkesës

27. Gjykata së pari vlerëson nëse janë përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.
28. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113 [Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara], paragrafi 7 i Kushtetutës, i cili parasheh:

“7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

29. Gjykata merr parasysh nenin 47 të Ligjit për Gjykatën i cili përcakton:

Kërkesa individuale

1. “Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik”.

30. Gjykata i referohet edhe rregullit 39 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës, i cili parasheh:

“(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.

31. Gjykata konstaton se kërkesa e parashtrueses i përmbush kriteret e nenit 113.7 sa i përket palës së autorizuar dhe shterjes së mjeteve juridike që është

parashtruar brenda afateve të nenit 49 të Ligjit, si dhe i plotëson kushtet për t'u shqyrtuar në Gjykatë.

32. Gjykata rikujton se parashtruesja ka pretenduar në mënyrë specifike se me Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, Pml. nr. 195/2017, të 11 tetorit 2017 të ndërlidhur edhe me vendimet tjera gjyqësore, asaj i janë shkelur të drejtat e njeriut sikur i ka theksuar në kërkesë dhe këtë veçanërisht” *sepse pa arsye është shpallur fajtores për veprën penale “e cila i vihet në barrë.*
33. Parashtruesja pretendimet e saj për shkelje të të drejtave Kushtetuese i ka mbështetur veçanërisht në faktin se sipas saj “*Gjykata Themelore në Kolegjin e përbërë prej tre anëtarëve e kishte anuluar aktgjykimin e gjyqtarit të vetëm të po asaj gjykate-dega në Lipjan, duke e kthyer çështjen në rivendosje*”.

Dispozitat relevante Kushtetuese të cilat pretendohen se janë shkelur dhe dispozitat e Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (KEDNJ) që ndërlidhen me këto të drejta

Neni 31 i Kushtetutës [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

“1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.

2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj”.

Neni 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit]

“1. E drejta e punës garantohet.

2. Secili person është i lirë të zgjedhë profesionin dhe vendin e punës”.

Neni 6. 1 (E drejta për një proces të rregullt), të KEDNJ-së, që përcakton:

“Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij”.

Dispozitat e ligjeve të lidhura me kërkesën

Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (Nr. 04/L-123)

Neni 493

Kërkesa për urdhër ndëshkimor

1. Për veprat penale për të cilat parashihet dënim me gjobë ose burgim deri në 3 (tri) vjet, për të cilat Prokurori i Shtetit është informuar në bazë të provave të besueshme nga kallëzimi penal, Prokurori i Shtetit mund të kërkojë në aktakuzë që gjykata të jep urdhër ndëshkimor, në të cilin të akuzuarit do t'i shqiptojë dënim përkatës pa e mbajtur shqyrtimin gjyqësor.

2. Prokurori i Shtetit mund të kërkojë shqiptimin e një ose më shumë masave vijuese: dënim me gjobë, ndalim të drejtimit të automjetit, urdhër për publikim të aktgjykimit, konfiskim të sendit, vërejtje gjyqësore ose konfiskim të dobisë pasurore të fituar me vepër penale”.

34. Gjykata rikujton se në bazë të nenit 53 të Kushtetutës [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] “*Të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut*” [GJEDNJ], andaj gjatë shqyrtimit të rasteve para saj, Gjykata i referohet praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së.
35. Rrjedhimisht, Gjykata, duke marrë parasysh praktikën e vet ligjore, praktikën ligjore të GJEDNJ-së, pretendimet e parashtrueses së kërkesës që i referohen të Drejtës për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm [neni 31 i Kushtetutës] i vlerëson të ndërlidhura me nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt] të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut [KEDNJ].
36. Gjatë shqyrtimit të pretendimeve për shkelje të së drejtave të njeriut për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, Gjykata vlerëson nëse procesi gjyqësor në tërësinë e tij ka qenë i drejtë dhe i paanshëm, ashtu sikur edhe kërkohet me nenin 31 të Kushtetutës (shih, ndër të tjera, *mutatis mutandis*, *Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 16 dhjetor 1992, f. 34, seria A. nr. 247, dhe *B. Vidal kundër Belgjikës*, 22 prill 1992. f. 33, seria A. nr. 235).
37. Gjykata vëren se argumentet e parashtrueses lidhur me shkeljen e së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm konsistojnë në konstatimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, gabimeve procedurale si dhe faktit që ajo konsideron se nuk ishte fajtorë për aksidentin e shkaktuar të komunikacionit .
38. Gjykata konstaton se procedura fillestare në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Dega në Lipjan, ishte zhvilluar në bazë të kërkesës së prokurorisë kompetente ku ishte kërkuar nxjerrja e një urdhri ndëshkimor sepse sipas prokurorisë kishte prova të mjaftueshme e të besueshme se parashtruesja ishte kryese e veprës penale për të cilën ngarkohej.
39. Nga Gjykata kërkohej që dënimi të shqiptohej pa seancë kryesore dëgjimore. Gjykata e aprovoi këtë kërkesë dhe me Aktgjykimin P. nr. 231/14 që përmbante urdhrin ndëshkimor e shqiptoi gjobën si në aktgjykimin e kontestuar.
40. Gjykata më tej vëren se parashtruesja kishte ushtruar kundërshtim kundër këtij aktgjykimi i cili ishte refuzuar si i paafatshëm nga gjyqtari i vetëm i po asaj

gjykate, ndërsa Kolegji i përbërë nga 3 (tre) gjyqtarë të Gjykatës Themelore në Prishtinë, ankesën e parashtrueses lidhur me kundërshtimin e refuzuar e aprovoi si të bazuar dhe çështjen e ktheu në vendimmarrje në seancë kryesore.

41. Kolegji kishte arsyetuar aktvendimin e tij me faktin se parashtruesja ankesën e kishte paraqitur me postë, andaj si datë dorëzimi duhej marrë datën e dorëzimit të ankesës, që është 23 shtatori 2014, pra brenda afatit të paraparë ligjor dhe në këtë mënyrë sipas Kolegjit konsiderohet se ankesa ishte e afatshme.
42. Në këtë drejtim, Gjykata konstaton se kur Kolegji i Gjykatës Themelore në Prishtinë vendosi që çështja juridike të kthehet në seancë dëgjimore, atëherë procesi ndaj parashtrueses filloi nga e para në shqyrtimin e meritave të rastit në gjykatën kompetente të shkallës së parë, duke caktuar edhe mbajtjen e seancave dëgjimore.
43. Gjykata gjithashtu vëren se pasi që çështja ishte kthyer në seancën e shqyrtimit kryesor, Gjykata Themelore në Prishtinë-Dega në Lipjan, në Aktgjykimin P. nr. 231/14, të 23 majit 2016, parashtruesen e ka shpallur fajtores dhe i ka shqiptuar gjobën me të holla si në aktgjykim.
44. Gjykata Themelore, ndër të tjera, në arsyetimin e aktgjykimit ka theksuar *“se e akuzuara Elife Murseli, ka kryer veprën penale, “Rrezikimi i trafikut publik” nga neni 378, par.6, lidhur me par. 1 të KPRK-së, gjë që u vërtetua në bazë të deklaratës së të dëmtuarit dëshmitarit K. Th. i cili në pyetjen e prokurorit lidhur me aksidentin shton se duke e drejtuar automjetin e tipit Audi F4 në drejtim të Prishtinës, me një shpejtësi prej afër 50-60 km/h, koha ishte e thatë dhe pa të reshura, dhe derisa i njëjti ishte duke lëvizur në shiritin e vet qarkullues, nga ana e kundërt ka ardhur një kombi të cilin e kanë tejkaluar dy vetura, e para Golf2, dhe kur është ofruar i njëjti afër kombit, atëherë vetura Golf 2 ka tentuar të hyjë në tejkallim, derisa i dëmtuari i kishte dhënë shenjë me drita të gjata, mirëpo vetura e tipit Golf ka filluar me tejkaluar kombin përderisa i njëjti ishte afër vetëm 4-5 metra, dhe e njëjta është ndeshur me veturën e tij”*.
45. Gjykata Themelore, më tej, arsyetoi se *“Mbrojtjen e të akuzuarës gjykata e ka vlerësuar por të njëjtës nuk ia fali besimin, ngase, si e tillë, është në kundërshtim të plotë me deklaratën e të dëmtuarit dhe ekspertizat e komunikacionit, pasi që me deklaratën e saj, e njëjta tenton që të ik nga përgjegjësitë penale për veprën penale të përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, dhe si e tillë nuk është aspak e besueshme”*.
46. Gjykata e Apelit, duke vlerësuar ankesën e parashtrueses ndaj Aktgjykimit të Gjykatës Themelore me Aktgjykimin PAI. nr. 859/2016, të 11 tetorit 2016, refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtrueses dhe vërtetoi aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë. Me atë rast, Gjykata e Apelit arsyetoi *“Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të administruara, drejt dhe në mënyrë të plotë ka vlerësuar të gjitha faktet relevante të kësaj çështje juridiko-penale dhe në bazë të tyre ka nxjerrë kolaudime të drejta dhe të ligjshme, arsyet të cilat i ka dhënë gjykata e shkallës së parë në arsyetimin e aktgjykimit të ankimuar si të drejta dhe të ligjshme në*

tërësi i aprovon edhe kjo gjykatë. Në ankesën e ushtruar me asgjë nuk sjellët në dyshim gjendja e fakteve të cilën e ka vërtetuar gjykata e shkallës së parë”.

47. Gjukata gjen se Gjukata e Apelit kishte vlerësuar të gjitha pretendimet e tjera të parashtrueses dhe të gjithave ju kishte dhënë përgjigjeje të plotë.
48. Gjukata më tej konstaton se Gjukata Supreme, duke shqyrtuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë me Aktgjykimin Pml. nr. 195/2017, kishte refuzuar kërkesën e parashtrueses duke arsyetuar, në mes tjerash, lidhur me aktgjykimet e goditura “*aktgjykimi është i përpiluar sipas kërkesave të Kodit të Procedurës Penale, ka dispozitiv të kuptueshëm dhe arsye ligjore për faktet vendimtare, bazuar në vlerësimin e drejt të provave të administruara në shqyrtimin gjyqësor, gjë që vlen edhe për aktgjykimin e shkallës së dytë, ashtu që pretendimi nga kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë ishte i pabazuar”.*
49. Gjukata rithekson se në mënyrë të vazhdueshme se interpretimi i ligjit, zbatimi i tij në çështjet konkrete, si dhe vlerësimi i fakteve dhe rrethanave janë çështje që ndajnë juridiksionin e gjykatave të rregullta nga juridiksioni kushtetues. Kontrolli kushtetues që ushtron kjo Gjykatë ndaj vendimeve gjyqësore, është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes së të drejtave kushtetuese të individit, kurse problemet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit për zgjidhjen e çështjeve konkrete nuk përbëjnë juridiksion kushtetues, nëse dhe për aq sa ato nuk shoqërohen me cenimin e këtyre të drejtave. (Shih, ndër shumë të tjerë, Aktvendimin e Gjykatës për rastin KI47-48/15, të 12 marsit 2015, parashtrues *Beqir Koskoviku e Mustafë Lutolli*).
50. Në të vërtetë, Gjukata thekson se detyra e saj është të vlerësojë nëse procedurat përkatëse të gjykatave të rregullta ishin të drejta në tërësinë e tyre, duke përfshirë edhe mënyrën e marrjes së provave, ose kanë qenë në ndonjë mënyrë të padrejta apo arbitrare (shih, *mutatis mutandis*, *Shub kundër Lituanisë*, paragrafi 16, Vendimi i GJEDNJ-së në lidhje me pranueshmërinë e kërkesës i 30 qershorit 2009; *Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, paragrafi 34, Aktgjykimi GJEDNJ-së i 16 dhjetorit 1992; *Barbera, Messeque dhe Jabardo kundër Spanjës*, paragrafi 68, Aktgjykimi GJEDNJ-së i 6 dhjetorit 1988).
51. Bazuar në parimin e subsidiaritetit, Gjukata nuk mund të marr rolin e gjykatës së shkallës së katërt dhe nuk gjykon lidhur me rezultatin përfundimtar të vendimeve gjyqësore (Shih *FeMetrebi v Georgia*, par. 31, Aktgjykimi i GJENDJ-së, i 31 korrikut 2007 shih, gjithashtu Aktvendimin e Gjykatës për rastin KI70/11 të parashtruesve *Faik Hima, Magbule Hima dhe Bestar Hima*, të 16 dhjetorit 2011).
52. Gjukata vëren se parashtruesja ka pasur mundësi të shumta që ta paraqes rastin e saj në Gjykatën Themelore në Prishtinë, në Gjykatën e Apelit dhe në Gjykatën Supreme, duke përdorur mjetet e ankimit ka marrë pjesë aktivisht në të gjitha fazat e procedurës gjyqësore, andaj procesi në tërësinë e tij nuk mund të cilësohet si arbitrar apo i padrejtë.
53. Në rrethanat e rastit, Gjukata nuk gjen se vendimet e gjykatave të rregullta janë arbitrare apo janë tregues i shkeljes të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, aq më tepër kur të gjitha pretendimet e parashtrueses kishin të bënin

për shkelje ligjore dhe jokushtetuese me ç' rast, parashtruesja në asnjë mënyrë nuk paraqiti prova se si, dhe, në cilat rrethana e drejta e pretenduar kushtetuese është shkelur.

54. Gjykata më tej konstaton se parashtruesja vetëm sa e ka përmend dispozitën e nenit 49 [E drejta e punës dhe ushtrimit të profesionit], duke mos ofruar asnjë provë nga e cila do të mund të konstatohej shkelja e kësaj dispozite kushtetuese.
55. Në fakt, Gjykata qartë konstaton se me asnjërin nga aktgjykimet e gjykatave të rregullta, parashtrueses nuk i është ndaluar e drejta e punës dhe as e ushtrimit të profesionit të saj. Për më tepër, kjo e drejtë kushtetuese as tërthorazi nuk ishte përmendur në asnjërin nga ato aktgjykime. Fakti që gjoba e shqiptuar në procedurë penale mund të ketë ndikim në punën e saj, nuk është provë në nivelin kushtetues për të gjetur shkelje të së drejtës së pretenduar.
56. Si përfundim, Gjykata konkludon se parashtruesja nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e saj për shkelje të të drejtave të garantuara me Kushtetutë, andaj në përputhje me rregullin 39 (2) kërkesa duhet të deklarohet e papranueshme si qartazi e pabazuar në baza kushtetuese.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe në pajtim me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës, më 11 dhjetor 2018, njëzëri

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë vendim ne Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Bajram Ljatifi



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi